

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Orig. Nr. Prot. 02/HARZ/1305 Prot. No. 2525-1/2024
 Org. Jedin. Org. Unit
 Nr. i faqeve Data 01.11.2024
 Broj stranica Datum
 No. pages: 1/1
 Dalëse PRISHTINËJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Drenasit	
	Gani Krasniqi , Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Jeton Qela , Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Arton Ahmeti , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Bora Duli , U.d Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 12.10.2024
Zyrtarët përgjegjës:	Shqiptar Ibra , Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor ,Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Referencë: 232/2024
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
 - I nderuari Kryesuese z. Krasniqi,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin 02 Nr.400/01-47985 për transfer të mjeteve financiare nga rezerva në kategorinë ekonomike investime kapitale
<i>I miratuar më datë 30.09.2024</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.10.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 04.10.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “**Ministria**”), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon transferimin e mjeteve nga Rezerva Komunale në kategorinë e investimeve Kapitale në shumë prej 30,000.00 euro.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i transferimit të mjeteve financiare evidentohet edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (këtej e tutje referuar si ‘Ligji i Buxhetit 2024’), Udhëzimet Administrative Nr.04.2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale (këtej e tutje referuar si ‘Udhëzimet Administrative’).
3. Kështu, në kuptim të transferit të mjeteve, neni 15, paragrafi 10 dhe 11 i Ligjit të Buxhetit 2022 përcakton se mjetet mund të barten dhe/apo transferohen në cilëndo kategori të shpenzimeve për të mundësuar zbatimin e një vendimi të formës së prerë nga autoritetet përmbartimore, si në vijim:

Neni 15

Transferi i shumave të ndara buxhetore

11. Mjetet nga "Rezerva" e OB-së mund të barten në cilëndo kategori të shpenzimeve për të mundësuar zbatimin e një vendimi të formës së prerë nga autoritetet përmbartimore. Këto lëvizje të buxhetit nuk janë subjekt i kufizimeve të transfereve të përfshira në nenin 30 të LMPPP-së dhe nenit 16 të këtij ligji.

4. Logjika e ndjekur me këtë dispozitë është se transferi mund të realizohet në cilëndo kategori të shpenzimeve vetëm atëherë kur kemi një vendim të formës së prerë nga autoritetet përmbartimore për t'u zbatuar.
5. Kjo aludon se rregulla të tjera aplikohen në mungesë të një vendimi të tillë. Kështu që, me paragrafin 11 të nenit 15 të Ligjit të Buxhetit 2024 përcaktohet se në rastet kur nuk kemi obligim të tillë përmbartimor për t'u zbatuar, mjeteve nga 'rezerva' mund të ndahen në kategorinë e 'shpenzimeve kapitale', në përputhje me Udhëzimet Administrative sipas paragrafit 2 të këtij vlerësimi.
6. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata buxhetore i ka transferuar mjetet nga kategoria e 'rezervës' në kategorinë e 'shpenzimeve kapitale'. Rrjedhimisht, vendimi komunal i nxjerrë nga Komuna e Drenasit mbetet i ligjshëm dhe si i tillë mund të zbatohet.
7. Si përfundim, **Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave iu mundësohet nxjerrja e vendimeve lidhur me bartjen e bilanceve të pashpenzuara**, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

Republika e Kosovës
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Nr. 020-606/2
 Datë: 03.10.2024



021740/010 2555/2024
 03.10.24

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Artan Ahmeti, U. d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 02.10.2024 VI-020-606
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për në MPFT	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 02 Nr. 400/01-47985 për transfer të mjeteve financiare nga rezerva në kategorinë ekonomike investime kapitale, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.
 Duke u bazuar në nenin 3 të Rregullore (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim 02 Nr. 400/01-47985 për transfer të mjeteve financiare nga rezerva në kategorinë ekonomike investime kapitale

I miratuar më datë: 30.09.2024

I parashituar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.10.2024

REPUBLIKA E KOSOVES - DRENSIT
 KOMUNA E DRENSIT
 Kuvendi i Komunës
 01/10/2024
 Nr. 018-696



Republika e Kosovës
 Komuna e Drenasit (Glllogoc)
 Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-47985 dt. 30/09/2024



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 34 pikë 34.6 nën (c) të statutit të Komunës së Drenasit, si dhe ligjit nr. 08/L-260, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.09.2024, miratoi këtë:

VENDIM PËR TRANSFER TË MJETEVE FINANCIARE NGA REZERVA NË KATEGORINË EKONOMIKE INVESTIME KAPITALE

Neni 1

Me këtë vendim për transfer, eldesinohen mjetet financiare nga Rezerva në Investime Kapitale në shumën 30,000.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare nga Rezerva (38) të nën-programeve:
 Shërbime Kulturore (85001), burimi i financimit (21) shuma prej 5,000.00 €,
 Planifikimi Urbanizimi Inspektoni (66310), burimi i financimit (22) shuma prej 25,000.00 €.

Transferohen në nën-programin:
 Arsimi filloz, i mesëm i ulët (93000), në Investime Kapitale (30), në projektin, Nr.55687-
 Kabineti në SHFMU D.Drenas, SHMP F.Lladrovci, D.Porçes, Sh.Polluzha, M.S.Bytyqi në
 shumën 30,000.00 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga MAPI-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.


 Miratuar në mbledhjen e JPK
 M. Krasniqi

Vendimi i dërgohet:

- Zyres së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatese;
- Zyres së Kuvëndit;
- Arkivit